



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut,
Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 11
Prishtinë, më 26. 05. 2010, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

P R O C E S V E R B A L

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në mbledhje morën pjesë: Nerxhivane Dauti, Luljeta Shehu, Ibrahim Makolli, Drita Maliqi, Ibrahim Selamanaj dhe Shpresa Murati.

Munguan: Hajredin Hyseni, Danush Ademi dhe Ismet Beqiri.

Pjesëmarrës të tjerë: Lejla Selimi – OSBE, Xhemajl Ahmeti – OHCHR, dhe Liridon Selmani – KDI.

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Visar Krasniqi.

Ismet Beqiri, kryetar, ishte në udhëtim zyrtar. Mbledhjen e drejtoi Nerxhivane Dauti.

Kryesuesja konstatoi se në bazë të Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Kosovës ishin plotësuar kushtet për mbajtjen e mbledhjes.

Në këtë mbledhje u propozua ky:

R e n d i d i t ë s

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.5.2010,
3. Marrja e qëndrimit të Komisionit lidhur me vërejtjen e dhënë në amendamentin nr. 1 në Projektligjin për mbrojtje nga dhuna në familje,
4. Shqyrtimi i disa ankesave të qytetarëve,
5. Te ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11. 5. 2010

Luljeta Shehu - Pati vërejtje për mospërfshirjen e diskutimit të saj, prandaj në kontekstet e diskutimit i shtohet si vijon: Ajo duke folur rreth Projektligjit për të pagjeturit tha se do të duhej të kemi informata më të sakta nga Komisioni qeveritar për të pagjeturit rreth këtyre çështjeve, sepse ne informatat i marrim vetëm përmes medieve, dhe nuk jemi të informuar zyrtarisht.

3. Marrja e qëndrimit të Komisionit lidhur me vërejtjen e dhënë në amendamentin nr. 1 në Projektligjin për mbrojtje nga dhuna në familje

Nerxhivane Dauti - I përshëndeti të pranishmit dhe monitoruesit e mbledhjeve të Komisionit dhe tha se Komisioni për Gjyqësi dhe Legjislacion i sugjeron Komisionit Funksional që amendamenti 1 (një) të rishikohet dhe të qartësohet se në cilat nene të ligjit hiqet fjala “tij dhe saj”, si dhe të përkufizimet të bëhet zëvendësimi i fjalës “nënkupton” me fjalën “është”.

Komisioni kur e ka miratuar këtë amendament është bazuar në teknikat standardeve të legjislacionet evropiane, të cilat iu shmangen këtyre fjalëve.

Lidhur me këtë çështje hapi debat

Komisioni Funksional e mbështet sugjerimin e Komisionit Gjyqësi dhe Legjislacion dhe vendos që ta fshijë amendamentin nr. 4, si dhe ta riformulojë amendamentin 1, si vijon: Neni dy në përkufizime fjala “nënkupton” zëvendësohet me fjalën “është”, duke i përshtatur në kontekst të fjalisë.

4. Shqyrtimi i disa ankesave të qytetarëve

NLB – Prishtina, i njofton institucionet e Kosovës – dhe Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione për parregullsitë, lidhur me zgjidhjen e kontestit, në aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Në mënyrë kronologjike e përshkruan çështjen juridiko-kontestuese, për të cilën konsideron se Gjykata Supreme e Kosovës nuk e ka zbatuar ligjin në fuqi. Arsyetimi i Gjykatës Supreme të Kosovës konsiderohet i paqëndrueshëm dhe se nuk përkon me nivelin e saj si instancë më e lartë. Ai kërkon nga institucionet shtetërore të ndërmerren të gjitha masat e nevojshme për t’u dhënë fund dukurive negative të shfaqura në gjyqësorin e Kosovës. Në vazhdim theksohet se do të kërkohet mbrojtja e ligjshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës. Komisioni nxori këtë:

Përfundim

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon t’i drejtohet Gjykatën Kushtetuese të Kosovës.

H. S. nga Ponosheci i Gjakovës, kërkon nga institucionet e Kosovës që t’i kthehen fëmijët dhe bashkëshortja nga Republika Federale e Gjermanisë. Ai thekson se familja e tij e ngushtë po mbahet në Gjermani pa bazë juridike dhe se pa të ndihet i kërcuar në Kosovë, prandaj kërkon nga Komisioni dhe

nga Ministria e Punëve të Jashtme t'i ofrojnë ndihmë institucionale. Gjithashtu thekson se deri më tani, Ambasada Gjermane në Prishtinë nuk ka bërë asgjë në zgjidhjen e çështjes.

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon atij t'i drejtohet serish me kërkesë ministrive.

Sh. Z. nga Prishtina, në kërkesën e saj për Komisionin për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Personat e Pagjetur dhe Peticione, kërkon përshpejtimin e procedurës rreth zbatimit të vendimit të KPMK - së nr. 02/90/2009, të 13. 08. 2009, sepse Ministria e Shëndetësisë deri më tani nuk ka marrë kurrfarë hapi për zbatimin e tij.

Prandaj kërkon nga institucionet relevante të Kosovës dhe Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore dhe Peticione, që në kuadër të fushëveprimit t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për zbatimin e vendimit.

Komisioni i rekomandon Ministrisë se Shëndetësisë t'i marrë të gjitha masat administrative në funksion të zbatimit të Vendimit të KPMK - së duke e informuar Komisionin lidhur me zgjidhjen e kërkesës.

Ibrahim Makolli - Duke folur për ankesat e qytetareve për moszbatimin e vendimeve të KPMK- së , propozoi që të kërkohej nga institucionet shtetërore, të cilave iu janë adresuar vendimet, të kërkohej informatë lidhur me veprimet e marra në drejtim të zbatimit të vendimeve të Këshillit Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Komisioni u pajtua me paraqelësin dhe lidhur me këtë nxori:

P ë r f u n d i m

Komisioni kërkon informatë nga institucionet për masat e ndërmarra rreth zbatimit të vendimit të plotfuqishëm të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Ish - punëtorët e fabrikës së tullave “Luboteni” në Ferizaj, me këtë përbërje: S. A. , H. Rr. , M. L. , I. H. , B. J. , D. M. dhe të tjerët, kërkojnë që ta shqyrtojë petitionin lidhur me shqetësimet e tyre të krijuara gjatë procesit të privatizimit.

Ata shqetësimet i adresojnë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, lidhur me shumën e 20 % të fabrikës tullave “Luboteni”, e cila gjendet në procesin e privatizimit.

Gjithashtu thuhet se disa persona pa bazë janë eliminuar në të drejtën e fitimit të 20 %, kurse në listë ka persona që nuk meritojnë të jenë.

Ata, si kërkesa që duhet të respektohen, paraqesin:

- Të dëgjohen në gjykatë të gjithë punëtorët e fabrikës “Luboteni”,
- Të ndërpritet dhënia e 20 % katër punëtorëve, të cilët janë përfshirë në listë,
- Dokumentet e ofruara të kthehen,
- Të ftohen punëtorët të cilët gjenden në listë.

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon nënshkruesve të petitionit t'i drejtohet sërish me kërkesë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës

Komisioni e shqyrtoi edhe ankesën nr. 211 të 6. 4. 2010 NLB - Prishtina duke i njoftuar edhe institucionet e Kosovës lidhur me parregullsitë, me zgjidhjen e kontestit në Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës. Komisioni iu rekomandon atyre të kërkohej mbrojtja e ligjshmërisë në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Komisioni konstatoi se kjo çështje nuk bie në fushëveprimin e tij, prandaj i rekomandon t'i drejtohet Gjykatës kushtetuese të Republikës së Kosovës për mbrojtje të ligjshmërisë.

5 Të ndryshme

Komisioni u njoftua me disa peticione të pashqyrtuara.

Mbledhja përfundoi në orën 14: 20

Nënkryetare e Komisionit

Nerxhivane Dauti